

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6631
E enjte, 16 qershor 2022
çmimi 0.40

Limaj: Sot në Kosovë kemi një politikë zyrtare anti-UÇK



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I KËSHILLIT EVROPIAN, CHARLES MICHEL,
KA VIZITUAR TË MËRKURËN KOSOVËN

MICHEL: KOSOVA TË MARRË PJESË NË NISMAT RAJONALE



Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, e ka inkurajuar Kosovën të marrë pjesë në forumet rajonale dhe të zbatojë agjendën për treg të përbashkët që, sipas tij, do ta sjellin rajonin më afër. "Dëshiroj që Kosova të marrë pjesë në forumet

regjionale dhe t'i implementojë të gjitha agjendat për një treg të përbashkët regional", ka thënë Michel, duke theksuar se fokus i institucioneve të Kosovës duhet të jetë procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara në të kaluarën

OPINION

'PROSERBI' EDVIN RAMA DHE 'PATRIOTI' BESNIK BISLIMI!

Behxhet Sh. SHALA – BAJGORA



AKTUALE



PKD-ja FTON DEPUTETËT TA VOTOJNË PROJEKTLIGJIN PËR TRUSTIN

ISH-MINISTRI GJERMAN I MBROJTJES NDEROHET NGA OSMANI ME 'MEDALJEN E URDRIT TË LIRISË'

EKONOMI



OEAQ-u FTON KOSOVËN T'I BASHKOHET INICIATIVËS SË "BALLKANIT TË HAPUR"

ATK-ja, NGA BALANCA KREDITORE E TVSH-SË, MBULON BORXHET E TATIMPAGUESVE

SPORT

KLUBET E KOSOVËS MËSOJNË KUNDËRSHTARËT E MUNDSHËM NËSE KALOJNË NË RAUNDET E TJERA TË GARAVE EVROPIANE

Rama dhe Abazoviqi vizitojnë Ukrainën



KMDLNJ-ja U BËN THIRRJE VETERANËVE TË LUFTËS PËR PROTESTË TË QETË

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Rama dhe Abazoviqi vizitojnë Ukrainën

Kiev, 15 qershor - Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe ai i Malit të Zi, Dritan Abazoviq, kanë mbërritur të mërkurën në kryeqytetin e Ukrainës, në Kiev. Përmes një postimi në rrjetet sociale, kryeministri Dritan Abazoviq dhe Edi Rama shfaqen të rrethuar nga forca të shumta të sigurisë teksa vizitojnë qytetin e Borodiankas në afërsi të Kievit. “Menjëherë pas mbërritjes sonë, vizituam qytetin e Borodiankas, një qytet i shkatërruar në fillim të pushtimit. Jemi dëshmitarë të shkatërrimit të shkaktuar nga lufta. Ne lutemi për paqe së bashku me kryeministrin Edi Rama dhe u qëndrojmë pranë

qytetarëve të Ukrainës”, ka shkruar Abazoviq në “Twitter”. Në një postim tjetër në “Twitter”, kryeministrat e dy shteteve të Ballkanit shihen duke vizituar edhe qytetin e Irpinit. “Ne vizituam qytetin Irpin, ku u shkatërruan 1 100 familje. Shumica e qytetarëve u larguan nga shtëpitë e tyre, infrastruktura u rrënuar... Ne e simpatizojmë Ukrainën për humbjen e shumë jetëve dhe vuajtjeve që po kalon prej muajsh. Paqja është e paçmueshme”, ka shkruar Abazoviq. Abazoviq dhe Rama janë liderët e parë të vendeve të Ballkanit Perëndimor që zyrtarisht e



vizitojnë Ukrainën e cila po përballet me agresion ushtarak nga Federata Ruse që nga 24 shkurti. Ata gjatë ditës do të takohen me presidentin ukrainas Volodymyr Zelensky. Qeveria e Malit të Zi ka njoftuar më 12 qershor se kreu i saj, Abazoviq, ka pranuar ftesën e

Zelenskyt. Ukraina ndodhet nën pushtimin e Ruses që nga 24 shkurti. Aktualisht luftimet janë të përqendruara në pjesën lindore të këtij vendi. Perëndimi e ka dënuar ashpër sulmin, duke e ndëshkuar Rusinë me sanksione të ashpër ekonomike dhe diplomatike.

Ukrainën, ndërkaq, është duke e ndihmuar me armatim. Presidenti i Ukrainës, Zelensky, ka mbajtur një fjalim para Kuvendit të Shqipërisë më 3 maj. Duke folur përmes videolidhjes, ai ka kërkuar nga ky vend që t'i mbyllë portet për anijet ruse dhe ta kufizojë ardhjen e turistëve rusë.

Stoltenbergu: Ukraina duhet të marrë më shumë armatime të rënda

BRUKSEL, 15 QERSHOR - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, ka thënë se vendet perëndimore duhet t'i dërgojnë Ukrainës më shumë armatime të rënda teksa forcat ruse vazhdojnë të përparojnë në lindje të vendit. Në një deklaratë për medie, pas takimit me shtatë liderët evropianë të vendeve aleate të NATO-s, Stoltenberg theksoi se Ukraina duhet të ketë më shumë armatime të rënda. Në prag të samitit të NATO-s që do të mbahet në fund të qershorit në Bruksel, Stoltenbergu u shpreh se, pavarësisht prej mbështetjes së koordinuar që aleanca i ka dhënë Ukrainës në më shumë se tre muaj luftë, kërkesat e Kievit për më shumë armatime janë rritur javët e fundit, pasi forcat e saj janë në disavantazh në luftën për t'i përballuar përparimet ruse në



Ukrainën lindore. Stoltenbergu ra dakord që Kievit duhet të furnizohet me më shumë armatime të rënda, por nuk dha detaje të tjera. Kryeministri holandez Mark Rutte dhe kryeministrja daneze Mette Frederiksen e pritën

Stoltenbergun dhe liderët e Polonisë, Rumanisë, Letonisë, Portugalisë dhe Belgjikës përpara samitit të NATO-s. Rutte tha se vendet e NATO-s, të përfaqësuara në takimin në Hagë, besonin të gjitha se “është thelbësore që Rusia ta humbasë

luftën” dhe Ukraina duhet të ketë qasje në të gjitha armatimet e nevojshme për ta fituar këtë betejë. Kryeministri polak Mateusz Morawiecki tha se veprimet e deritanishme të Perëndimit nuk e kanë mbështetur mjaftueshëm Ukrainën. “Ne nuk kemi bërë mjaftueshëm për ta mbrojtur popullin ukrainas, për ta mbështetur lirinë dhe sovranitetin e tyre”, tha ai në konferencën për shtyp. Dhe kjo është arsyeja pse unë ju bëj thirrje, ju kërkoj të bëni shumë më tepër për të dërguar armë, artilleri në Ukrainë. Ata kanë nevojë për këto në mënyrë që ta mbrojnë vendin e tyre”. Vendet perëndimore nuk do të kishin besueshmëri nëse Ukraina do të humbiste kundër Ruses,

shtoi ai. “Ky do të ishte një dështim dhe katastrofë e plotë e Bashkimit Evropian, e vlerave tona dhe e NATO-s”, tha Morawiecki. Stoltenbergu tha se liderët e NATO-s do të “bien dakord për një afirmim më të madh të qëndrimit tonë” në samitin e Madridit. NATO duhet të ndërtojë “gatishmëri edhe më të lartë” dhe t'i forcojë aftësitë e saj të armatimeve përgjatë kufirit të saj lindor në vazhden e pushtimit rus të Ukrainës, shtoi ai. I pyetur në lidhje me aplikimet e Suedisë dhe Finlandës për t'u bashkuar me aleancën, Stoltenbergu tha se ai po kërkonte “një rrugë të bashkuar përpara” për ta zgjidhur kundërshtimin nga Turqia, e cila kritikon hapur atë që ajo e konsideron si mbështetje suedeze ndaj militantëve kurdë.

Zvicra mbyll hapësirën e saj ajrore pas defektit kompjuterik

GJENEVE, 15 QERSHOR - Zvicra mbyll hapësirën ajrore të mërkurën pas një defekti kompjuterik me sistemin e kontrollit të trafikut ajror që solli ndalimin e fluturimeve. Lajmi u dha nga zyrtarët e autoritetit civil të aviacionit zviceran ku thuhej

se: “Hapësira ajrore zvicerane është e mbyllur për trafikun ajror për arsye sigurie pas dështimit të kompjuterit me Skyguide, shërbimin zviceran të kontrollit të trafikut ajror”.

Në deklaratë nuk u dha asnjë detaj në lidhje me

keqfunksionimin e sistemit kompjuterik, por thuhej se “kërkohet ndjesë për këtë incident dhe pasojat e tij për klientët, partnerët dhe pasagjerët e aeroporteve të Gjenevës dhe Zyrihut dhe se po punohet për të gjetur një

zgjidhje”. Më herët, aeroporti i Gjenevës tha në një postim në “Twitter” se po ndalonte të gjitha fluturimet e tij deri në orën 11.00 të mëngjesit (0900 GMT) për shkak të dështimit të sistemit kompjuterik. Agjencia zvicerane



e lajmeve “ATS-Keystone” tha se fluturimet ndërkombëtare për në Zvicër po ridrejtohen drejt Milanos.

KMDLNj-ja i thërret veteranët e luftës për protestë të qetë



Për shkak të mospërfshirjes në Projektligjin për pagën minimale, shoqatat e veteranëve të luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës kanë paralajmëruar këtë të enjte protestë kundër diskriminimit që po u bëhet veteranëve, invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve për shkak të mospërfshirjes në Projektligjin për pagën minimale

“Epoka e re”

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Sot (e enjte) organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, prej orës 9:30, para objektit të qeverisë dhe para Kuvendit të Kosovës do të organizojnë protestë kundër diskriminimit që po u bëhet veteranëve, invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve për shkak të mospërfshirjes në Projektligjin për pagën minimale. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka bërë thirrje për protestë të qetë të

veteranëve të luftës. “KMDLNj edhe më herët i ka përkrahur kërkesat e drejta të veteranëve të luftës që të përfshihen në Projektligjin për pagën minimale duke deklaruar se edhe kjo pagë as për së afërmi nuk i plotëson nevojat e veteranëve të luftës dhe është në shpërputhje të madhe me situatën e krijuar ekonomike e mos të flasim me kontributin e madh që e kanë dhënë para, gjatë dhe pas përfundimit të luftës në Kosovë. KMDLNj edhe më herët ka kundërshtuar numrin e veteranëve por, pasi kjo çështje është duke u

trajtuar nga institucionet e drejtësisë, rezervohet nga deklaratat publike. Sido që të jetë, KMDLNj konsideron se protesta e paralajmëruar e veteranëve të luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës është plotësisht e drejtë dhe paraqet përpjekje për mbrojtje të të drejtave të njeriut të kësaj kategorie që kohën e fundit, përveç shpërfilljes institucionale nga përfaqësuesit e institucioneve që duhet t'i mbrojnë, në mënyrën më brutale dhe më të panjërëzshme po fyhen, po stigmatizohen duke anashkaluar dhe mohuar kontributin e tyre të pamohueshëm për liri dhe çlirim të Kosovës”, është thënë në reagimin e KMDLNj-së, duke theksuar se përgjegjësia për trajtim jonjerëzor të veteranëve të luftës dhe kontribuuesve të tjerë për liri dhe çlirim të Kosovës nuk është vetëm i kësaj qeverie por i të gjitha

qeverive paraprake e që kjo qeveri, me mospërfshirjen në Projektligjin për pagë minimale, i ka vënë kapakun e diskriminimit. KMDLNj ka bërë me dije se do ta monitorojë protestën e paralajmëruar të veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe shpreson se kjo protestë krejtësisht e drejtë dhe e arsyeshme do të jetë paqësore duke përjashtuar çdo lloj dhune nga cilado palë dhe, në të njëjtën kohë, thërret palët që t'u përmbahen rregullave të një proteste paqësore. “Çdo përdorim i dhunës nga cilado palë për KMDLNj-në do të jetë e papranueshme dhe, si e tillë, nuk do të përkrahjet”, theksohet në reagimin e KMDLNj-së. Lëvizja për Bashkim (LB) përmes një deklaratë për medie ka njoftuar se do ta mbështetë këtë protestë. “LB-ja, e bindur në drejtësinë e kësaj çështjeje të ngritur nga OVL e

UÇK-së, ka vendosur që ta mbështesë protestën dhe do të marrë pjesë aktive në të. LB-ja është e bindur se këndvështrimi i mbrapshtë që, kinse kategoritë e dala nga lufta qenkan barrë për shoqërinë, është antinjerëzor dhe antikombëtar. Me projektligjin e Qeverisë së Kosovës, të miratuar në lexim të parë nga Kuvendi i Kosovës, rrezohet ligji aktual që e lidh pensionin e veteranit me pagën minimale, (edhe ashtu ka qenë pension shumë i vogël, 170 euro), pra nuk do të ketë rritje për këtë kategori ashtu siç parasheh projektligji për pagën minimale”, është thënë në deklaratën e kësaj partie.

Lëvizja për Bashkim i fton jo vetëm veteranët, por të gjithë qytetarët t'i bashkohen protestës dhe të mos lejojnë që kategoritë më meritore për lirinë që po e gëzojmë, të shndërrohen në kategori sociale.

Ish-ministri gjerman i Mbrojtjes nderohet nga Osmani me “Medaljen e Urdhrit të Lirisë”

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, në një ceremoni të mbajtur në Presidencë, me motivacionin “për kontribut për lirinë e Kosovës”, ia ka dorëzuar “Medaljen Urdhri i Lirisë” ish-ministrit të Mbrojtjes të Gjermanisë, Rudolf Scharping. Kjo medalje i është akorduar z. Scharping në vitin 2004 nga presidenti Ibrahim Rugova, porse nuk i është dorëzuar asnjëherë. Gjatë luftës në Kosovë, më

1999, Scharping kishte përkrahur intervenimin e NATO-s, teksa në ditarin e tij “Nuk guxojmë të shikojmë mënjane: Lufta e Kosovës dhe Evropa”, ka paraqitur zhvillimet politike të këtij misioni. Presidentja Osmani ka theksuar se dekorimi i ish-ministrit gjerman përkon me 23-vjetorin e çlirimit të Kosovës për të cilën ai ishte meritore. “Siç thoshte presidenti historik, dr. Ibrahim Rugova, shtëpia nuk mbahet pa miq. Kjo dekoratë

dëshmon se Kosova di t'i nderojë miqtë, ata që në orët e errëta të historisë i dolën në krah. Z. Scharping është një nga meritoret për lirinë që e gëzojmë. Populli i Kosovës do të jetë përherë mirënjohës ndaj angazhimit të tij për lirinë tonë”, ka theksuar presidentja Osmani.

Kurse Scharping ka falënderuar presidenten Osmani për dekorimin, duke theksuar se është i nderuar që kontributi i tij vlerësohet nga institucionet dhe populli i Kosovës.





Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, ka vizituar të mërkurën Kosovën

Michel: Kosova të marrë pjesë në nismat rajonale

Presidenti i Këshillit Evropian, Charles Michel, pas takimit me presidenten Vjosa Osmani, e ka inkurajuar Kosovën të marrë pjesë në forumet rajonale dhe të zbatojë agjenda për treg të përbashkët që, sipas tij, do ta sjellin rajonin më afër së bashku. “Dëshiroj që Kosova të marrë pjesë në forumet regjionale dhe t’i implementojë të gjitha agjendat për një treg të përbashkët regjional”, ka thënë Michel, duke theksuar se fokusi i institucioneve të Kosovës duhet të jetë procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara në të kaluarën

EPOKA E RE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të mërkurën në takim presidentin e Këshillit Evropian, Charles Michel.

Ky i fundit ka inkurajuar Kosovën që të marrë pjesë në forumet rajonale dhe të zbatojë agjenda për treg të përbashkët që, sipas tij, do ta sjellin rajonin më afër së bashku. “Dëshiroj që Kosova të marrë pjesë në forumet regjionale dhe t’i implementojë të gjitha agjendat për një treg të përbashkët regjional”, ka thënë Michel, duke shtuar se BE-ja do të vazhdojë ta mbështesë Kosovën. Ai shtoi se Ballkani Perëndimor është prioritet strategjik për BE-në. Gjithashtu, Michel ka thënë se

fokusi i institucioneve të Kosovës duhet të jetë procesi i normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë dhe zbatimi i marrëveshjeve të nënshkruara në të kaluarën. “Të dyja palët duhet të përparojnë në zbatimin e marrëveshjeve të kaluara”, ka thënë Michel të mërkurën në një konferencë të përbashkët me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani.

Lidhur me këtë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se Kosova është e përkushtuar në procesin e dialogut me Serbinë si palë konstruktive. “Për Kosovën dialogu nuk është vetëm kërkesë nga ndërkombëtarët, por proces jetik”, ka shtuar Osmani.

Ajo ka shtuar se që të arrihen rezultate konkrete në procesin e dialogut, edhe Serbia duhet ta njohë realitetin. Siç ka thënë ajo,

Kosova deri më tani nuk e ka bllokuar procesin e dialogut dhe një gjë të tillë nuk do ta bëjë as në të ardhmen.

Osmani dhe Michel, po ashtu, e kanë komentuar procesin e liberalizimit të vizave për Kosovën. Michel ka thënë se “shtetet anëtare të BE-së duhet të vendosin për këtë çështje të rëndësishme për ju”.

Kosova që nga viti 2016 i ka plotësuar të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave me BE-në.

Presidentja Osmani ka thënë se liberalizimi i vizave për popullin e Kosovës mbetet çështja kryesore, duke shtuar se duhet të ketë angazhim aktiv në mënyrë që shtetet të votojnë.

Sipas saj, deri tani ka pasur “diskriminim dhe padrejtësi të thellë”.

Duke ritheksuar faktin që Kosova

është e përkushtuar për stabilitet rajonal dhe vepron mbi baza të vlerave evropiane, Osmani ka thënë se ka ardhur koha që marrëdhëniet ndërmjet BE-së dhe Kosovës të ngrihen në nivel më të lartë. “Pavarësisht prej përkushtimit tonë, mospërbushja e premtimeve në raport me rajonin tonë e teston besueshmërinë në BE-në, duke lënë hapësirë për ndikim të jashtëm. Por, kemi nevojë urgjente që BE-ja ta bëjë të qartë perspektivën evropiane të rajonit dhe Kosovës”, ka shtuar Osmani, duke shtuar se integrimi evropian është vullnet i palëkundur i popullit të Kosovës. “Vlerat evropiane kanë qenë udhërrëfyesi ynë kryesor përgjatë historisë. Në kohën kur këto vlera ndodhen nën kërcënim, Evropa është më e fortë kur është e njëzëshme dhe e bashkuar. Në këtë vizitë të rëndësishme të presidentit të Këshillit Evropian Charles Michel në Kosovë, ripohova përkushtimin tonë për integrimin e Kosovës në BE, shkëmbyem idetë për të investuar në rininë tonë energjike, për t’ua mundësuar lëvizjen e lirë qytetarëve tanë dhe për ta forcuar partneritetin tonë”, ka deklaruar

Osmani.

Presidenti Michel, po ashtu, theksoi se javën e ardhshme do të takohet me liderët e 27 vendeve të BE-së, duke e cilësuar si mundësi “që të shfaqet uniteti për vlerat tona të përbashkëta”. “Është shumë e rëndësishme për ne t’i kryejmë detyrat e shtëpisë dhe në këtë takim në fund të qershorit duhet t’i konfirmojmë detyrimet politike të cilat i kemi karshi Ballkanit”, ka thënë ai.

Sipas draftkonkluzave të përgatitura nga Charles Michel, Këshilli Evropian do ta përsërisë nevojën urgjente për arritjen e “progresit të prekshëm” në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të hapura në Ballkanin Perëndimor, me theks në dialogun Kosovë - Serbi, i cili duhet ta synojë “normalizimin e marrëdhënieve” mes dy vendeve.

Michel ka falënderuar presidenten Osmani dhe autoritetet e Kosovës në përgjithësi për pozicionin e saj ndaj luftës në Ukrainë dhe vendosjes së sanksioneve ndaj Rusisë.

Vizita e Michelit në Kosovë është në kuadër të vizitave të tij në disa shtete të rajonit.

Limaj: Sot në Kosovë kemi një politikë zyrtare kundër UÇK-së

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka kritikuar qëndrimin e presidentes Vjosa Osmani dhe të kryeministrit Albin Kurti ndaj UÇK-së. Në intervistën dhënë gazetës "Nacionale", ai ka thënë se sot në Kosovë ka një politikë zyrtare kundër UÇK-së e cila po udhëhiqet nga institucionet qendrore. "Sot kemi një politikë zyrtare anti-liri dhe anti-UÇK, e cila po drejtohet nga kjo qeveri. Shoqëria kosovare përballë kësaj politike nuk duhet të

heshtë dhe nuk duhet ta ulë kokën", ka deklaruar ai.

Limaj ka ftuar shoqërinë e Kosovës të mos heshtë ndaj kësaj politike.

Lideri i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka kërkuar shkarkimin e ministres së Punëve të Jashtme dhe të Diasporës, Donika Gërvalla. Ai ka bërë me dije se qëndrimet e saj ndaj UÇK-së janë qëndrime të presidentes Vjosa Osmani dhe të kryeministrit Albin Kurti.

I pyetur për qeverisjen e Kurtit,

Limaj ka theksuar se kjo qeveri asnjë të mirë nuk e ka bërë. "Ma thoni vetëm një gjë të mirë që e ka bërë ai gjatë kësaj periudhe të qeverisjes. Ma thoni një vendim, një qëndrim, apo një projekt i cili do të tregonte se këtu ka një ndryshim. Mendoj se ky i ka tejkaluar parashikimet negative. Unë nuk kam pritur asgjë nga ky por, megjithatë, na i ka tejkaluar me parashikime negative. Në qeveri është grumbulluar një grup njerëzish të paaftë, të papërvojë, pa motiv dhe pa dashuri për vendin. Ata

sot i kanë dhënë një status quo zhvillimit të shtetit të Kosovës në tërësi", ka deklaruar Limaj.

Lideri i Nismës e ka kritikuar edhe opozitën. "Fatkeqësisht ne sot kemi një opozitë anemike dhe të paorganizuar. Drejtuesit e partive opozitare ende nuk kanë treguar se cila është platforma dhe opozitëbërja e tyre. Daljet e kohëpaskohshme janë për deputetë të opozitës, opinionistët dhe intelektualët. Liderët e opozitës duhet të dalin me një platformë të qartë opozitare, në vazhdimësi e në

çdo kohë. Deri më tani kemi parë një opozitë sporadike në reagime. Kjo opozitë më tepër reagon sesa që krijon politika opozitare. Sot më opozitë i ke mediet në Kosovë sesa që ke një opozitë të mirëfilltë. Ato parti nuk ngritin çështje në kohën dhe mënyrën e duhur në Kuvendin e Kosovës. Po ashtu, i shoh se as grupet parlamentare nuk janë të koordinuara në aktivitete. Shpresoj se do të ringjallen. Por, tani për tani kemi një opozitë larg prej asaj që duhet të jetë", ka thënë Limaj.



Fakulteti Juridik inauguron këndet e reja të leximit për studentët

PRISHTINË, 15 QERSHOR (ER) - Në ambientet e Fakultetit Juridik është bërë inaugurimi i këndeve të leximit, të dedikuara për studentët e këtij fakulteti.

Në këtë ceremoni rektori i Universitetit të Prishtinës, prof. dr. Naser Sahiti, i shoqëruar nga prorektorja për mësimdhënie dhe çështje për studentë, prof. asoc. dr. Mimoza Ibrani, u mirëprit nga dekani i Fakultetit të Juridikut, prof. ass. dr. Avni Puka dhe stafi i kësaj njësie akademike. Me këtë rast, rektori Sahiti tha se investimet e tilla janë të rëndësishme dhe shumë të nevojshme pothuajse për secilin fakultet të UP-së, sepse me anë të tyre krijohet atmosferë më e këndshme për

lexim dhe hapësirë për rrjetëzim në mesin e studentëve.

Ndërkaq, dekani Puka njoftoi se janë bërë të gjitha investimet e nevojshme në këtë holl të leximit, përfshirë këtu edhe furnizimin me literaturë mjaft të larmishme, e cila do të jetë gjatë gjithë kohës në dispozicion për shfrytëzim nga ana e studentëve. Ky projekt, i ideuar nga studentët e Fakultetit të Arkitekturës, të udhëhequr nga profesoresha Arta Xhambazi, ka paraparë edhe infrastrukturën e nevojshme për lehtësimin e qasjes për personat me aftësi të kufizuara. Kjo e fundit tha se kjo nismë do të vijojë edhe me projekte të tjera të cilat do të rezultojnë me hapësira më të mira për studentët tanë.



'Proserbi' Edvin Rama dhe 'patrioti' Besnik Bislimi!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Prej Skenderi del beteri...: Në përvjetorin e çlirimit të Kosovës u organizuan disa manifestime e që, sipas meje, më mirë do të ishte të mos organizoheshin fare. Pati aq shumë injorime ndaj meritueses kryesore për çlirimin e Kosovës e që, pa asnjë dyshim, është Ushtria e Lavdishme Çlirimtare e Kosovës sa që nxitnin dilema mos janë deklarata të Serbisë dhe udhëheqësve të saj e jo të Kosovës dhe liderëve të saj. Ta mohosh rolin e UÇK-së që pati rol vendimtar në çlirimin e Kosovës arsyetohet vetëm nëse e keni dëshminë e mjekut specialist se jeni 99 për qind i çmendur, kurrsesi ndryshe! Të manipulosh, për shkaqe politike me heronjtë, varret dhe varrezat (titull i huazuar nga Ernesto Sabato), përveçse është poshtërsi skajshmërisht e pamoralshme, në të njëjtën kohë është hapje e varrit vullnetarisht ku vendoset e kaluara, dikur shumë e mirë, e tashmja manipuluese dhe regjistrimi në pjesën e historisë apo kapitullin e plehrave njerëzorë, kombëtarë dhe moralë, pa mundësi riciklimi për të ardhmen! Të thuash se pengjet që po mbahen në Hagë janë kriminelë duke kontribuar në arrestimin e tyre qoftë përmes deklaramit publik se do të dorëzohen dosje kundër tyre apo edhe dëshmi të drejtpërdrejta, në bashkëpunim me UDB-në dhe BIA-në e Serbisë kurse, në anën tjetër, të kërkosh t'i vizitosh në burg është poshtërsi që nuk i gjeni as në romanin e devijimeve ekstreme morale të Markiz de Sad por, te ne kjo thujaja është shndërruar në sjellje dhe standard moral. Të dhunosh aq shumë të drejtat e veteranëve të UÇK-së e që kanë qenë ushtarë të pengjeve të Hagës dhe, përsëri, duke u mbuluar me hi apo duke sajuar arsyetime çoroditëse të kërkosh t'i vizitosh, as të arriturat më të përparuar të neuropsikiatrisë nuk do të jenë në gjendje t'i arsyetojnë!

Shqiptarët që kanë mbijetuar në Kosovën e okupuar nga Serbia dhe

Jugosllavia sikur edhe ata që kanë mbijetuar në territoret e okupuara, shpresën për shndërrim të mbijetesës në një jetesë e kanë pasur te Shqipëria sepse nuk kishin tjetër atdhe. As sot nuk kemi tjetër atdhe! Edhe në kohën e luftës së parë botërore, luftërave ballkanike, para luftës së dytë botërore, pas kësaj lufte, ndonëse nuk kishim fare informata për Shqipërinë, në idealizmin tonë, mbase edhe verbërues, Shqipërinë e kishim pikëshpresë, pikësynim dhe spirancë ku anijen apo Varkën e Noas që do ta ruante farën dhe popullin shqiptar do ta ankoronim pikërisht në Shqipëri. Ani pse Mbreti Zog na dërgonte në moçalishte, se Enver Hoxha mbushte burgjet dhe kampet e përqëndrimin me të internuar shqiptarë të ikur nga Kosova, për ne që vazhdonim të mbijetonim jashtë atdheut, po kjo Shqipëri ishte Parajsa vet. Për të burgosurit politikë shqiptarë në ish-Jugosllavi, ëndrra shqiptare dhe ekzistenca e Shqipërisë ishte përcaktues për të qëndruar vertikalisht dhe për t'u bërë ballë të gjitha vuajtjeve dhe torturave të cilat nuk ishin të pakta. Po të mos ishte Shqipëria, e tillë siç ishte dhe me mundësitë që i kishte, nuk do të kishte as luftë e të lavdishme Ushtri Çlirimtare e Kosovës. Sigurisht se po të mos ishte kjo Shqipëri dhe shqiptarët që kanë jetuar në viset e shkëputura nga ish-Jugosllavia, sot në Kosovë numri i shqiptarëve do të ishte simbolik, i papërfillshëm fare! Edhe pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, është çfarë është, Shqipëria ishte adresa e parë dhe më e besueshme për shqiptarët dhe Kosovën. Shumë shqiptarë e kanë përkrahur Fan Nolin jo shkak u tij por se ka qenë në krye të Shqipërisë. E njëjta gjë ishte edhe me Zogun që u bë mbret pa qenë mbret asnjë i familjes së tij edhe në 500 vjetëshin para lindjes së Ahmet Zogut. E kanë përkrahur edhe Enver Hoxhën jo shkak se Enver Hoxha ishte kombëtar por se ishte në krye të Shqipërisë. Sipas

të njëjtin parim janë përkrahur Sali Berisha, Fatos Nano dhe, së fundi edhe Edi Rama. Madje, kur Edi Rama foli si foli në Beograd gjatë vizitës së parë, shqiptarët e Kosovës e vunë mbi Ismail Qemalin kurse tani, për shkaqe të inateve politike dhe kompleksit të inferioritetit, disa prej tyre po përpiqen t'i vendosin mbi kokë kurorën e proserbit dhe tradhëtarit!

Po si erdhi te ky haxhiqamilizëm i disa kosovarëve ndaj Edi Ramës: Shqiptarët e kanë si moto personale thënë se: "dy atlarë, nuk lidhen në një mullar...". Sidomos këta që mendojnë se, qoftë edhe si delikuentë seksualë dhe duke iu nënshtruar pornografisë morale bëhen pjesë e politikës ose e institucioneve të Kosovës. Fillimisht të gjithë kërkojnë përkrahje nga Shqipëria dhe Edi Rama e pastaj, me t'u prekur prapanica në karriken e pushtetit deklarojnë se nuk e pranojnë qëndrimin paternalist të Shqipërisë dhe të Edi Ramës sepse Kosova qenka shtet i pavarur dhe sovran sikur që i paska udhëheqësit e zgjedhur e që kanë mandat t'i përfaqësojnë. Natyrisht, në këto rrethana Shqipëria tërhiqet sikur që as Edi Rama nuk e ka më vullnetin që të angazhohet për Kosovën dhe liderucët e saj. Në zgjedhjet e fundit në Shqipëri, në mungesë të guximit për të votuar në Luginën e Presheves për Kuvend të Serbisë dhe Sobranje të Maqedonisë së Veriut, liderët e Kosovës morën pjesë në zgjedhjet në Shqipëri e që asnjë njeri normal nuk do ta pranonte. Kaluan si kaluan dhe këtë luftë e vendosën në planin personal, kush do të bëhet Baba i të gjithë shqiptarëve. Natyrisht se Intelektuali i Madh shqiptar, Rexhep Qosja, për shkak të moshës nuk ishte kandidat për Baba të Kombit (eventualisht mund të zgjidhej Gjysh i Kombit), dhe lufta ra në dy emra, Edi Rama dhe Albin Kurti. Kjo luftë nuk u imponua nga Edi

Rama sa nga Albin Kurti. Albin Kurti e kishte personale edhe luftën me Hashim Thaçin derisa e dhanë kontribut modest që Thaçi të dërgohet në Hagë përmes thirrjeve në Kuvendin e Kosovës: "Hashim, shko në Hagë.." Pasi i fitoi 51 për qind të votave, me eliminimin e Hashim Thaçit nga skena politike, Albini luftën e personalizoi me Edi Ramën, për ta eliminuar si të parin e të gjithë shqiptarëve e që kam përshtypjen që Edi Rama asnjëherë nuk e ka pasur qëllim! Me kalimin e kohës, disa media, në përpjekje për servilosje përfituese nga Albin Kurti, filluan ta sulmojnë Ramën duke ia hequr cipën e virgjërisë së një të paprekuri dhe duke bërë përpjekje t'i fusin një purri antikombëtar përkatësisht duke e cilësuar si proserb. Madje, iu dukej pak ta quanin vetëm Edi Rama por thonin, Edvin Kristaq Rama, për t'ia forcuar ortodoksizmin përmes emrit të babait dhe përkatësinë proserbe. Ballkani i Hapur ishte rasti më i mirë që Edi Rama të sulmohej dhe të cilësohej si antikrist i çështjes kombëtare dje si apostull i çështjes serbe! Këta që e sulmojnë sot Ramën dikur e pushkatonin Albinin si djalë politik të Adem Demaçit dhe Rexhep Qosjes dhe, pa asnjë dyshim të njëjtën gjë do ta bëjnë në çastin kur Albini, eventualisht do të binte nga fiku (pushteti)! Asnjëherë nuk i kam marrë seriozisht por se për mua ka qenë befasi e madhe që më ka lënë pa gjumë dhe qetësi, deklaratat kundër Edi Ramës, të cilësuar si proserb, të patriotëve të dëshmuar dhe sakrifikues të papërsëritshëm për çështjen kombëtare ndër gjenerata dhe shekuj të Bislës, Rokfelerit të Uroshevcit dhe haxhiqamilit seksual. Edi Rama konsiderohet si politikan aksidental që paska hyrë rastësisht në politikë e ku, i pari midis të parëve është thujaja 20 vjet, që ia ka ndryshuar fytyrën Tiranës dhe Shqipërisë e që "rastësisht" po e ushtron mandatin e tretë si kryeminister i Shqipërisë. Për Edi Ramën thonë se është maniak,

përdorues i drogës, hajdut, ekscentrik dhe i çmendur dhe, së fundi sipas pohimeve dhe postimeve të një patrioti dhe komandanti të shquar të njëjësive subversive në periudhën e pasluftës i mirënjohur si Komandant Leshi, qenka: "njeri i mirë por pak proserb...". E ky Komandant Leshi postin më të lartë që e ka dhe do ta ketë në të ardhmen është se është kryeservil i kryekomandantit politik dhe komandant i vogël i një grupi të vogël mercenarësh (jo të gjithë) paraardhësit e të cilëve me shpi dhe me thi i kanë shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë sikur që sot marrin paga thujaja 20 herë më të mëdha se ndihmat sociale që e merr një veteran i UÇK-së me pretendime se do ta zgjidhin fatin e Kosovës, pa "proserbin" Edi Rama dhe me "patriotin" Besnik Bislimi! Edi Rama mund të jetë edhe i çmendur por e ka një çmenduri krijuese ku rezultatet janë edhe të dukshme, edhe të prekshme. Po këta tanët çka bënë deri më sot?! Përveçse duan ta çojnë vendin në luftë qytetare duke nëpërkëmbur vlerat e vërteta kombëtare dhe duke afirmuar agentët e UDB-së dhe të BIA-së! Njeriu, në çaste të caktuara ka nevojë edhe për armik që të respekton e lëre më për një politikan që mendon, flet dhe vepron shqip. Edhe në rast se është i çmendur. Përfundimisht, deri më sot askush nuk mund të më bind se Edi Rama është proserb dhe antishqiptar sikur që askush nuk mund të më bind se Besnik Bislimi është patriot më i madh se Edi Rama. Është patriot, por është patriot i vogël sepse është bërë patriot i inxhinieringut për përdorim të përkohshëm politik. Nuk thuhet kot se: "Shqiponja nuk gjuan miza prandaj as Besniku nuk e gjuan Vuçiqin por bën përpjekje të Don Kishotit që ta gjuaj Ramën duke e cilësuar si pak proserb...". Ka mundur të bëhet edhe më keq dhe Bisla ta cilësojë Edi Ramën si shumë proserb! Është treguar i matur, në vlerësim dhe cilësim! Meriton respekt, deri në Gjylekar!

OEAK-u fton Kosovën t'i bashkohet iniciativës së 'Ballkanit të hapur'

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Duke njohur rëndësinë e koordinimit dhe integritet ekonomik, stabilitetit dhe prosperitetit të Ballkanit Perëndimor përmes lëvizjes së lirë të mallrave, njerëzve, kapitalit dhe shërbimeve, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i ka bërë thirrje Qeverisë së Kosovës që të konsiderojë në mënyrë serioze pjesëmarrjen në iniciativën për tregun e përbashkët rajonal. "Oda Amerikane rithekson thirrjet e përfaqësuesve të administratës të Shteteve të Bashkuara se çfarëdo initiative e bashkëpunimit rajonal duhet të mundësojë përfaqësim të barabartë të të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe se është përgjegjësi e tri shteteve nismëtare të 'Ballkanit të hapur', që t'i adresojnë brengat e Qeverisë së Kosovës dhe ato të vendeve të tjera skeptike. Asnjë iniciativë për treg të përbashkët rajonal nuk mund të ketë sukses në rrethana kur jo të gjitha shtetet e rajonit trajtohen në mënyrë të barabartë dhe me respekt, dhe nëse nuk bëhen përpjekje serioze për largimin e aspekteve që irritojnë



bashkëpunimin", është thënë në deklaratën e kësaj ode. Oda Amerikane shpreh besimin e saj të fuqishëm se bashkëpunimi ekonomik nuk ka alternativë në këto kohë të pasigurta për ekonomitë

rajonale dhe globale dhe se vetëm përmes integritet ekonomik vendet do të mund t'i tejkalojnë vështirësitë e ardhshme, siç janë sfidat në zinxhirët e furnizimit, siguria e ushqimit, mungesat e

energjisë dhe mungesat e fuqisë punëtore. Në fund, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë beson se është e një rëndësie tejet të madhe që të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor të

reshtohen me politikat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Evropian, duke mbajtur qëndrim të harmonizuar duke dënuar invazionin rus të Ukrainës përmes sanksioneve.

ATK-ja, nga balanca kreditore e TVSh-së, mbulon borxhet e tatimpaguesve



EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar të gjithë tatimpaguesit se duke filluar nga data 21 qershor 2022 do t'i iniciojë procedurat e verifikimit të kreditimit në TVSh për të gjithë tatimpaguesit të cilët janë në balancë kreditore të TVSh-së dhe, në anën tjetër, kanë borxhe të papaguara në ATK. "Pra, ATK-ja do t'i iniciojë procedurat e verifikimit të kreditimit në TVSh dhe me kreditimin e vlefshëm të TVSh-së do t'i mbulojë borxhet e papaguara të tatimpaguesit, i cili është në balancë kreditore të

TVSh-së dhe në anën tjetër ka borxhe në ATK", është thënë në njoftimin për medie. Sipas këtij njoftimi, bazuar në nenin 30 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenin 41 të Udhëzimit Administrativ nr. 15/2010, Administrata Tatimore e Kosovës ka të drejtë ta iniciojë procedurën e rimbursimit të TVSh-së për tatimpaguesit të cilët janë në balancë kreditore mbi tre muaj radhazi dhe shuma e kreditimit është mbi 3 000 euro dhe i njëjti tatimpagues ka borxhe tatimore prej më shumë se pesë mijë eurosh. "Administrata Tatimore e Kosovës, pasi ta konstatojë

saktësinë e balancës kreditore në deklaratën e TVSh-së, me mjetet e tilla do ta mbulojë borxhin tatimor të tatimpaguesit dhe pjesën e mbetur (nëse mbetet) do ta rimbursojë në llogarinë bankare të tatimpaguesit. Pas zbatimit të procedurës së lartshënuar, tatimpaguesi do të njoftohet në formë zyrtare lidhur me bartjen e balancës kreditore në borxhet tatimore, se cilat lloje të tatimeve/kontributeve janë mbuluar, periudhën tatimore, si dhe për pjesën e rimbursimit eventual që do të transferohet në llogari bankare të tatimpaguesit", është theksuar në njoftimin e ATK-së.

Instituti GAP: Gjysma e punëtorëve të RTK-së me pagë 1 000 deri 1 500 euro

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Mbi gjysma e punëtorëve të Radio Televizionit të Kosovës kanë paga neto prej 1 mijë deri në 1 500 euro, thuhet në një publikim të Institutit për Studime të Avancuara GAP. Sipas GAP-it, këto të dhëna janë nga

Administrata Tatimore e Kosovës për 900 punëtorët e RTK-së. Instituti GAP thekson se në dhjetor të vitit të kaluar ishin rreth 990 të punësuar. Prej këtyre, 23.3 për qind janë në grupin e atyre që marrin pagë prej 1 mijë deri

1 200 euro, kurse 28.1 për qind pagë nga 1 200 deri 1 500 euro. Po ashtu, 17.4 për qind e të punësuarve në RTK marrin pagë deri 1 800 euro. Në RTK ka prej atyre që marrin pagë mbi 3 000, e që janë më pak se 1 për qind.



Përhap teori konspirative të çuditshme, kush është Nikolai Patrushev, këshilltari më i afërt i Vladimir Putin mbi Ukrainën



Nga Susanne STERNTHAL

Nikolai Patrushev, është një nga këshilltarët më të afërt të presidentit rus Vladimir Putin. Ai ka një ndikim të madh në politikën e qeverisë ruse, në cilësinë e kreut të Këshillit të Sigurimit të Rosisë. Këshilli është vendi ku formulohet politika ruse e sigurisë, dhe qendra ku merren informacione nga burime dhe rrjetet agenturore jashtë Rosisë.

Patrushev është ai që i interpreton të dhënat që vijnë nga agjentët rusë nëpër botë. Patrushev jep shpesh intervista për mediat shtetërore ruse në lidhje me pikëpamjet e tij konspirative ndaj Perëndimit, dhe atë që Kremlinin e përshkruan ende si një “operacion ushtarak special” të Rosisë në Ukrainë.

Nuk ka asgjë mënyrë për ta përgjeshtruar dezinformimin e tij, pasi të gjitha mediat e pavarura në Rusi janë mbyllur. Dhe kjo duhet të jetë shqetësuese për SHBA-në dhe aleatët e tjerë perëndimorë. Si një studiues që merret prej kohësh me Putinin dhe rrethin e tij të ngushtë, për mua është e qartë se marrëdhënia e ngushtë e Patrushevi me Putinin, që ka nisur më shumë se 50 vjet më parë, i ka dhënë atij një ndikim të fortë mbi presidentin.

Që të dy e dënojnë shembjen e Bashkimit Sovjetik, dhe që të dy janë shumë mosbesues ndaj Perëndimit, një ndjenjë që ushqehet nga teori konspirative absurde. Patrushev është shfaqur

si një nga zërat kryesorë në rrethin e brendshëm të Putinit, që dëshiron zhvillimin e një lufte të pamëshirshme në Ukrainë, me objektivin përfundimtar pushtimin e Kievit.

Mark Galeoti, ekspert britanik mbi shërbimet ruse të sigurisë, thotë se Patrushev është ideologu më i djathtë i Putinit dhe quhet “Skifteri i Skifterëve” brenda rrethit të brendshëm të presidentit rus. Këtu përfshihen ata që ashtu si Patrushev, vazhdojnë të përsërisin dezinformimin se Ukraina është një vend plot me nazistë, dhe se Rusia duhet të mbrohet nga planet e liga të Perëndimit.

Patrushev nuk ngurron të japë intervista. Unë kam lexuar shumë nga intervistat dhe esetë e tij, dhe ato nuk zhgënjnë asnjëherë, duke zbuluar mënyrën e tij konspirative të tëmenduarit. Më 26 prill 2022, Patrushev dha një intervistë për gazetën shtetërore ruse “Rossiskaya gazeta”.

Ai e filloi me temën e tij të preferuar: synimet e liga të Perëndimit në përgjithësi, dhe të Shteteve të Bashkuara në veçanti. Patrushev tha se ndërsa vendet e tjera janë të frikësuar nga SHBA dhe “nuk mund të ngrënë as kokën”, Rusia “jo vetëm ka guxuar, por ka deklaruar publikisht se nuk do të luajë sipas rregullave të vendosura” nga Amerika.

Në fakt, qeveria ruse nuk ka gënjyer në ato që ka thënë, siç dëshmohet nga lufta brutale që po bën kundër Ukrainës dhe popullit të saj, e cila është në

kundërshtim flagrant me të gjitha konventat e luftës. Gjatë intervistës, Patrushev flet për një “komunitet kriminelësh të arratisur nga Ukraina, të cilët janë tani të angazhuar në biznesin e përhapur të shitjes së jetimëve që janë larguar nga Ukraina”.

Ndërkohë, Perëndimi, pohon Patrushev, “ka ringjallur tashmë tregun e zi të blerjes së organeve njerëzore në dëm të segmenteve socialisht të cenueshme të popullsisë ukrainase, për operacione klandestine transplantimi për pacientët evropianë”.

Perëndimi, vazhdon më tej Patrushev “po u jep mbështetje neo-nazistëve ukrainas, duke vazhduar ta furnizojë me armë ukrainën”. Më pas Patrushev citon Putinin, që e quajti Perëndimin një “perandori të gënjeshtrës”, pasi ishin vendosur sanksionet. Sipas botëkuptimit të Patrushevi, Perëndimi synon që të zvogëlojë “në mënyra të ndryshme popullsinë e botës”.

Putin dhe Patrushev njihen që nga viti 1970. Të dy vijnë nga Leningradi, sot Shën Petersburgu, dhe kanë punuar bashkë në KGB-në e Leningradit në departamente të ndryshme. Po ashtu, që të dy shërbyen në qeverinë e Boris Jelcinin. Në vitin 1998, Jelcin e emëroi Putinin për të udhëhequr FSB-në, pasardhësin e KGB-së, ndërsa Patrushev u bë zëvendësi i tij i parë.

Kur Jelcin e emëroi Putinin si kryeministër në detyrë më 9 gusht 1999, Patrushev zëvendësoi Putinin si drejtor i

FSB-së. Mbrëmjen e Vitit të Ri 1999, Jelcin bëri njoftimin e papritur se Putini do ta zëvendësonte atë si president në detyrë. Putin i fitoi zgjedhjet presidenciale më 26 mars 2000.

Pak para se Putini të fitonte zgjedhjet, marrëdhënia e ngushtë Putin-Patrushev u shfaq në sytë të gjithëve, kur të dy vendosën që natën e Vitit të Ri 2000, të shkonin në Çeçeni bashkë me gratë e tyre për të takuar trupat ruse që luftonin atje. Kjo ndodhi gjatë Luftës së Dytë Çeçenitë viteve 1999-2009. Pavarësisht masakrave që kryenin përditë në terren trupat ruse ndaj civilëve çeçenë, Putin dhe Patrushev hapën 2 shishe shampanjë, dhe të dyja çiftet pinë ndërsa po udhëtonin me një helikopter mbi zonën e luftimit. Pasi kaluan një orë me një njësi ushtarësh rusë të befazuamga prania e tyre, ata u rikthyen në Moskë.

Një javë përpara inaugurimit të Putinit si presidenti 7 maj 2000, gazeta ruse “Kommersant” vuri në dukje se Putini ishte duke e mbushur administratën e tij të re me ish-zyrtarë nga FSB, agjencia kryesore e sigurisë ruse, së bashku me SVR, Shërbimin e Inteligjencës së Jashtme, që kishte qenë gjithashtu pjesë e KGB-ja gjatë periudhës sovjetike, por që tani ishte një agjenci më vete.

Në një artikull të mëpasshëm, “Kommersant” shkroi se agjentët e vendosën “jetën politike në Rusi nën kontrollin e plotë të Kremlinin, nëpërmjet metodave të KGB-së”. Në një intervistë dhënë për mediat në dhjetor

2000, Patrushev sqaroi edhe dominimin e ish-zyrtarëve të FSB dhe SVR në Kremlin, administratën presidenciale dhe në rajonet periferike të Federatës Ruse.

“Ata janë vendosur në nivelet më të larta të pushtetit, pasi kanë pasur role udhëheqëse në institucionet e sigurisë kombëtare”- tha ai. Patrushev shtoi se ekzistonte një “nevojë jetike për të ringjallur trupin administrativ rus me ‘gjak të freskët’... jo me idealistë naivë, por me pragmatistë të ashpër që kuptojnë zhvillimet politike ndërkombëtare dhe të brendshme, kontradiktat dhe kërcënimet që shfaqen”.

I emëruar në vitin 2008, Patrushev është bërë sekretari më jetëgjatë i Këshillit të Sigurimit. Që atëherë, këshilli ka ndryshuar shumë në krahasim me vitet 1990, kur ishte një mënyrë për të sistemuar me punë veteranët e moshuar të forcave të sigurisë. Patrushev e ka shndërruar atë në një institucion dinamik, që merret me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me sigurinë e Rosisë, dhe është pozicionuar si kryekëshilltari i Putinit.

Galeoti beson se Patrushev është i rrezikshëm për shkak të “mendësisë së tij paranojake të orientuar nga konspiracionet”. Kjo është thelbësore për të kuptuar Rusinë e sotme, sepse idetë konspirative të Patrushevi dhe këndvështrimi i tij mbi botën, janë thjerrëza përmes së cilës e sheh botën edhe miku i tij Vladimir Putin. /

“The Conversation” – Bota.al



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Klubet e Kosovës mësojnë kundërshtarët e mundshëm nëse kalojnë në raundet e tjera të garave evropiane



PRISHTINË, 15 JANAR - Katër klubet e BKT Superligës së Kosovës, Ballkani, Llapi, Drita dhe Gjilani, do ta prezantojnë futbollin në arenën ndërkombëtare. Këto skuadra, pasi mësuat skuadrat e para kundërshtarë, të mërkurën kanë mësuat edhe ekipet e mundshme kundërshtarë nëse kalojnë më tutje në raundet e ardhshme të garave evropiane si Liga e Kampionëve apo Liga e Konferencës.

Kampioni në fuqi, Ballkani, fillimisht përballet me lituanezët e Zalgirisit dhe, nëse arrin fitore, në raundin e dytë kualifikues do të përballet me Malmon ose fituesin e raundit parakualifikues. Mirëpo nëse Ballkani pëson humbje nga Zalgiris, kundërshtar eventuale në Ligën e Konferencës do të jetë humbësi i ndeshjes gjysmëfinale të raundit parakualifikues të Ligës së Kampionëve, La Fiorita e

San Marinos apo Inter Club d'Escaldes i Andorrës. Kundërshtarët e ardhshëm të mundshëm i kanë mësuat edhe fituesi i Kupës, Llapi dhe dy skuadrat e tjera që do të paraqiten në sezonin e ardhshëm në garat evropiane, Drita dhe Gjilani. Llapi në raundin e parë kualifikues do të përballet me Buducnostin e Podgoricës dhe nëse e kalon këtë raund, do të luajë kundër fituesit të ndeshjes në mes të klubit nga Islanda, Breidablik dhe atij nga Andorra, Santa Coloma. Gjilani që luan me Liepajan në raundin e parë të Ligës së Konferencës, në të dytin nëse kualifikohet do të përballet me gjigantin zviceran Young Boys. Skuadra e Dritës që ndeshet me finlandezët e Inter Turkut, nëse kualifikohet tutje, do të përballet gjithashtu me një ekip të fortë si belgët e Royal Antwerpit.

FGJK-ja organizon për herë të parë aktivitetin 'Gjimnastrada e Kosovës'

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Federata e Gjmnastikës e Kosovës do ta organizojë edicionin e parë të aktivitetit "Gjimnastrada e Kosovës", në të cilin do të marrin pjesë më shumë se 150 fëmijë nga të gjitha klubet e gjmnastikës. Ky aktivitet do të mbahet

ditën e shtunë më 18 qershor, në orën 10:00, në Fakultetin e Edukimit Fizik në Prishtinë. Ndryshe nga aktivitetet e mëparshme, ky aktivitet do të mbahet në prani të shikuesve. FGJK-së iu ka bërë thirrje prindërve dhe dashamirësve të sportit që të

marrin pjesë në këtë aktivitet të veçantë gjmnastikor. Gjimnastrada është performancë grupore, ku nuk ka një numër të përcaktuar pjesëmarrësish, është pa dallim moshe, gjinie, apo race. Ajo në vetvete ndërlidh artin e kërcimit, koreografisë

dhe ushtrimeve akrobatike. Gjithashtu, është një aktivitet zyrtar i FIG (Federata Internacionale e Gjmnastikës), që mbahet çdo katër vjet dhe tërheq numrin më të madh të pjesëmarrësve aktivë të çdo ngjarje të FIG-ut.



Ramadani: Presim të kalojmë në raundin tjetër

GJILAN, 15 QERSHOR - Trajneri i Gjilanit, Zekirija Ramadani, ka dhënë komentet e tij pas shortit në Ligën e Konferencës. Të martën në Nyon është tërhequr shorti për garat evropiane, ku skuadrat nga Kosova mësuat kundërshtarët e tyre. Gjilani do të përballet me skuadrën Liepaja dhe për këtë short disa fjalë ka thënë trajneri Ramadani. "Një kundërshtar i respektuar në këtë fazë të garës. Kemi filluar mbledhjen e informacioneve për kundërshtarin edhe pse kemi

pak njohuri, pasi që kemi parë ndeshjen me Strugën në edicionin e kaluar. Do të përgatitemi sa më mirë për këto dy ndeshje dhe presim që të kalojmë këtë raund të garës, pasi që qëllimi është të kualifikohemi sa më larg", ka thënë Ramadani. Gjilani shkon në këto gara pas një sezoni relativisht të mirë në Superligën e Kosovës, por me një trajner tjetër në krye. Nëse skuadra e Gjilanit e kalon Liepajan, atëherë do të përballet me Young Boysin në raundin tjetër.



Lëndohet Donjeta Sadiku, mungon në Lojërat Mesdhetare

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Boksierja Donjeta Sadiku, e cila fitoi muajin e kaluar medaljen e bronzit në Kampionatin Botëror të

Boksit, të mbajtur në Stamboll të Turqisë, nuk do të marrë pjesë në Lojërat Mesdhetare "Oran 2022". Sadiku ka pësuar një lëndim

në dorë gjatë përgatitjeve, për çka e ka të ndaluar të garojë për të paktën një muaj. Krahas Donjetës, në Oran nuk do të udhëtojnë as

përzgjedhësi i femrave në boks, Faton Xhakli. Ekipi mesdhetar përbëhet nga 39 sportistë, 16 trajnerë dhe tre gjyqtarë.



Ekipi i xhudos po bëhet gati për Lojërat Mesdhetare

PRISHTINË, 15 QERSHOR - Ekipi i xhudos është duke u përgatitur në Poreç të Kroacisë për Lojërat Mesdhetare. Ekipi i xhudos, i cili në këto përgatitje po mbështetet financiarisht nga Komiteti

Olimpik i Kosovës, në "Oran 2022" do të marrë pjesë me garuesit: Distria Krasniqi, Akil Gjakova, Loriana Kuka, Laura Fazliu, Flaka Loxha, Erza Muminoviq, Shpat Zekaj dhe Arbër Kullashi, të cilët

do të udhëhiqen nga trajneri Driton Kuka dhe ndihmëstrajnerja Majlinda Kelmendi. Lojërat Mesdhetare "Oran 2022" do të mbahen nga 25 qershori deri më 6 korrik. Ekipi

mesdhetar i Kosovës përbëhet nga 39 sportistë, 16 trajnerë dhe 3 gjyqtarë. Sportistët e Kosovës do të përpiqen ta japin maksimumin në mënyrë që t'i sjellin medalje vendit të tyre.



Torino dëshiron ta blejë kartonin e Berishës

TORINO, 15 QERSHOR - Portieri i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, do të vazhdojë të qëndrojë në Serinë A edhe në sezonin e ardhshëm. Portieri i Spalit pritet të transferohet përfundimisht të Torino, me klubin "Granata" që ka vendosur ta blejë kartonin e portierit të kombëtares kuqezi. Berisha iu bashkua Torinos verën e kaluar nga Spali në formë huazimi. Dhe pas një niseje në stol, dalëngadalë ai nisi ta fitonte besimin e trajnerit dhe në fundin e sezonit që sapo u mbyll ai u kthye në një titullar të padiskutueshëm në portën e kësaj skuadre. Ai zhvilloi dhjetë takime me Torinon në sezonin që lamë pas duke u ndëshkuar me një karton të verdhë, teksa në katër raste mundi ta ruante portën të paprekur. Paraqitja e tij e ka bindur klubin që të paguajë te Spali klauzolën për blerjen e kartonit. Sipas medieve italiane, Torino pritet të paguajë në ditët në vazhdim 1 milion euro në llogarinë e Spalit për ta blerë përfundimisht kartonin e portierit kuqezi. Sipas medieve italiane, në vendimin e klubit të Torinos për ta blerë kartonin e Berishës ka ndikuar edhe trajneri Juriç, që ka besim të plotë te shqiptari.



US Open lejon pjesëmarrjen e tenistëve rusë dhe bjellorusë



BROOKLINE, 15 QERSHOR - Organizatorët e grand slam të US Open në tenis (nis më 29 gusht) kanë konfirmuar se të gjithë tenistët që vijnë nga Rusia dhe Bjellorusia mund të luajnë në këtë turne. I vetmi grand slam që i përjashtoi tenistët e këtyre dy vendeve është Wimbledon, që nis pas dy javësh. Pas vendimit që mori turneu londinez, u vendos nga ATP (meshkujt) dhe WTA

(femrat) që për pjesëmarrësit të mos jepen pikë. Ndërkohë që US Open vendosi t'u hapë dyert të gjithë tenistëve, pavarësisht luftës që Rusia ka nisur në Ukrainë prej më shumë se tre muajsh. Kështu, në US Open mund të rikthehet të luajë kampioni në fuqi, rusi Daniil Medvedev, aktualisht numri një në botë. Do të luajnë gjithashtu edhe Andrey Rublev, Karen Khachanov,

Aryna Sabalenka, Victoria Azarenka, Daria Kasaktina etj. "Secila federatë merr vendimet në bazë të rrethanave të ndryshme, pa u ndikuar nga organizatat e tjera. Ne, duke u bazuar në situatën tonë, vendosëm të lejojmë t'i gjithë tenistët të marrin pjesë. Tenistët rusë e bjellorusë do të garojnë si neutralë", thanë organizatorët e US Open.

SHKURT

Liçeni fiton ndeshjen e parë finale ndaj Liburnit

FC Liçeni e ka fituar ndeshjen e parë të finales së "play-off" -it të Superligës së Kosovës në futsall. Skuadra nga Drenasi e ka mposhtur skuadrën e Liburnit në Gjakovë me rezultat 5:2. Kjo përballje solli lojë tejet interesante dhe angazhim të madh të të dyja ekipeve. Rezultati pas kohës së rregullt ishte 2:2, kurse pas dy shtesave nga 5 minuta Liçeni arriti të fitojë 5:2. Ndeshja e radhës do të luhet të shtunë në Drenas.

Muriqi vendoset në shitje nga City

Manchester City e ka marrë vendimin final për portierin e Përfaqësueses së Kosovës, Arijanet Muriq. Ky i fundit është huazuar vazhdimisht në vitet e fundit në liga të ndryshme. Muriqi nuk e ka bindur trajnerin Pep Guardiola, i cili ka hequr përfundimisht dorë nga gjiganti i portës. Portali britanik "mancitysquare" raporton se "Citizens" ka vendosur që mos ta huazojë më 23-vjeçarin, por ta shesë përfundimisht. Portieri shqiptar nga Mali i Zi ishte huazuar në ekipet si NAC Breda, Nottingham Forest, Girona, Willem II dhe Adana Demirspor, ku e kaloi edicionin që sapo përfundoi.

Januzaj mund të bashkohet me trajnerin Moyes

Klubi anglez West Ham United ka shfaqur interesim për yllin shqiptar Adnan Januzaj. 27-vjeçari i ka përfundon kontrata me Real Sociedadin në këtë muaj. Ish-anësori sulmues i Manchester Unitedit mund të ribashkohet me trajnerin e tij të vjetër David Moyes. Sipas mediumit "Diario de Sevilla", West Hami është në mesin e disa skuadrave që i ofrojnë Januzajt një kontratë. Interesim për anësorin ka shfaqur edhe Real Betisi dhe Napoli.

Donnarumma: Na mungoi gjithçka, rikthehem me të fortë

Italia pësoi humbje nga Gjermania me rezultat të thellë 5-2. Portieri Gianluigi Donnarumma ka thënë se janë të dëshpëruar me paraqitjen e bërë, por ka premtuar se Italia do të rikthehet edhe më e fortë. "Na ka munguar gjithçka. Kishte një lodhje pas katër ndeshjeve, por nuk duam të shfaqesohemi. Ne jemi vërtet të dëshpëruar për tifozët, për atë që ata panë sonte. Do të analizojmë gjithçka dhe do të fillojmë përsëri. Duhet të pushojmë dhe të kthehem me të fortë", ka thënë Donnarumma.

Bayerni arrin marrëveshjen me Manen

Sulmuesi Sadio Mane pritet të transferohet nga Liverpooli te Bayern Muncheni. Këtë gjë e ka bërë me dije gazetari italian Fabrizio Romano. Sipas tij, sulmuesi senegalez dhe Bayerni kanë arritur një marrëveshje së bashku, pra një marrëveshje personale dhe verbale. Kontrata thuhet se do të jetë trevjeçare, por ende nuk dihet se sa do të jetë paga e sulmuesit. Palët janë shumë afër dhe tashmë ekipi gjerman do të bisedojë me anglezët për ta arritur marrëveshjen me shifrat e transferimit.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Njoftim

Anulohet konkursi për drejtor në Qendrën Burimore për mësim dhe këshillim “Nënë Tereza” në Prizreni, i shpallur me 11.04.2022.

Obaveštenje

Otkazuje se konkurs za direktora Resursnog centra za nastavu i savetovanje „Majka Tereza“ u Prizrenu, raspisan 11.04.2022.



Republika e Kosovës
 Republika Kosova - Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada - Government
 Trepça Shoqëri Aksionare
 Trepça Deoničarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 15.06.2022 bënë shpallje publike:

NJOFTIM PËR DHËNIE KONTRATËS: T-22-04

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e hapësirës në Industrinë Kimike
 Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë
 Numri i ofertave të pranuar: 1(një)

ME KONTRATË SHPËRBLEHET

INNO RECYCLING me çmimin 509.76 euro me TVSH.

Kontratat janë paraparë të nënshkruhet me datën 23.06.2022 ora 10:00

AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtarë: Trepça sh.a.		
Adresa postare: Parku inustrial		
Qyteti: Mitrovicë	Kodi postarë: 40000	Shteti: Kosovë
Kontakti: Burim HAJDINI		Telefoni: +383 (0) 28 538 050
Email: sales@trepcacorporation.com		Faksi: +383 (0) 28 539 202
www.trepcacorporation.com		

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokollit 119 datë 11.01.2021.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



www.facebook.com/gjeipuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Nexhat Ajdini shpall të pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Flori Arifi shpall të pavlefshme dëftesën e kl X shmlt "11 Marsi " Prizren.
- ▶ Artan Gashi shpall të pavlefshme dëftesat e kl VI- IX shfmu "17 Shkurti " Atmaxhe.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

